



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

INDUSTRIA PËRPUNUESE

SEKTORI C - 2022



Nëntor, 2023

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Sektori – C (Industria Përpunuese).....	4
Të dhënat e përgjithshme të sektorit – C.....	4
Përpunimi i produkteve ushqimore.....	5
Prodhimi i pijeve.....	6
Prodhimi i tekstilit.....	7
Prodhimi i veshjeve.....	8
Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës.....	9
Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje	10
Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës.....	11
Prodhimi i Produkteve Kimike.....	12
Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe të Plastikës.....	13
Prodhimi i produkteve minerale jo metalike.....	14
Prodhimi i Metaleve.....	15
Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve	16
Prodhimi i Mobileve.....	17

1. HYRJE

Zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), me theks të veçantë sektori i prodhimit si dhe nismat për privatizim janë hapat e parë të proceseve drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integriteteve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në ekonominë e Kosovës ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë, me rreth 98%.

Prodhimi ka një potencial të lartë për të krijuar produktivitet të konsiderueshëm dhe fitime shtesë në vlerë duke tërhequr teknologjitë e reja dhe inovacionin. Zhvillimi industrial mund të ketë gjithashtu implikime të shumta pozitive zhvillimore përtej sektorit të prodhimit.

Për të pasur një pasqyrë të shkurtër/përmbledhës të gjendjes apo trendëve të zhvillimit të industrisë, DPI ka përgatitur broshurën ku janë paraqitur të dhëna për sektorin prodhues dhe për nën sektorët me potencial si: përpunimi i ushqimit, prodhimit të pijeve, tekstilit, veshjeve, lëkurës, drurit, letrës, industrisë kimike, prodhimit të produkteve jo-metalike, produkteve të fabrikua metalike (përveç makinerisë dhe pajisjeve), plastika dhe goma, metalet dhe prodhimi i mobileve.

Këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar nga përpunuesit e statistikave dhe hartuesit e politikave industriale në Departamentin e Industrisë/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

<https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/7B358FA1-BF80-4A4A-9973-495E561E8303.pdf>

SEKTORI – C (INDUSTRIA PËRPUNUESE)

Spektori i prodhimit mund të japë kontribut të rëndësishëm në punësimin gjithëpërfshirëse dhe paga më të mira edhe pse aktualisht ofron mundësi relativisht të kufizuara punësimi ku Spektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë rreth 11%, gjithashtu të dhënat tregojnë se Spektori - C, në vitin 2022 ka shënuar rritje në punësim për 6%, në qarkullim për 12.5% dhe në numër të ndërmarrjeve për 3%, krahasuar me vitin 2021, ndërsa punësimi i grave në Industri për vitin 2022 ka shënuar rritje për 5%.

2.2 Të dhënat e përgjithshme të sektorit – C (Industrië përpunuese), janë si në vijim:

- Spektori-C (Industria përpunuese) merr pjesë me 13.2% në BPV të Kosovës;
- Në vitin 2022, pjesëmarrja e Sektorit-C në BPV është rritur për 2.32%, krahasuar me vitin 2021,
- Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve, Industria merr pjesë me 12.89%,
- Në vitin 2022, niveli i industrializimit i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV, është 13.6%,
- Pjesëmarrja e industrië përpunuese, në vitin 2021, në eksportin e përgjithshëm ishte rreth 82.9%, kurse në importin e përgjithshëm rreth 92.63%,
- Nga 6162 ndërmarrje sa janë në sektorin C, rreth 22% e ndërmarrje janë eksportuese,
- Pjesëmarrja në eksport, në vitin 2021 ishte 626 milion euro dhe ka shënuar rritje për 57.2%,
- Importi në vitin 2021, në Sektorin-C, ishte 3.06 miliard euro, ndërsa në vitin 2021, 4.33 miliard euro, që do të thotë se ka shënuar rritje për 41.73%, derisa në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 kishte rënie për 5.9%;
- Spektori-C, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.8%;
- Norma efektive e interesit në sektorin e industrië përpunuese është 6%.
- Hyrjet neto të IHD-ve në sektorin e prodhimit ishin 14.3 milion euro

2. PËRPUNIMI I PRODUKTEVE USHQIMORE

Industria e ushqimit përfshin llojet të ndryshme të produkteve ushqimore, të cilat janë: mishi, mielli, qumështi, vaji, sheqeri, pemë dhe perime të ndryshme etj. Rritja e këtij nën sektori nuk pritet të shquhet si lokomotivë e krijimit të madh të vendeve të punës, përkundër faktit se nën sektori aktualisht është burim i konsiderueshëm i punësimit. Megjithatë, deficit i theksuar tregtar mund të adresohet përmes veprimeve të caktuara që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së brendshme dhe të jashtme të produkteve të këtij nën sektori. Nën sektori ka një potencial të konsiderueshëm zëvendësues të importit. Politikat që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së nën sektorit duke përfshirë rritjen e madhësisë së firmës dhe ekonomive të shkallës, dhe përmirësimin e mundshëm të integritetit të zinxhirit të furnizimit, mund të veprojnë për të përmirësuar bilancin e tij tregtar dhe potencialisht të çojnë në rritje intensive të punës.



Të dhënat e nën sektorit të Përpunimit të produkteve ushqimore, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve Ushqimore” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 23.7%, ndërsa në numër të ndërmarrjeve me 24.4% dhe në qarkullim vjetor me 21.7%, (Vitit 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Ushqimore, merr pjesë me 5.9%, (Vitit 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 7.1%, (Vitit 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Ushqimore, merr pjesë me 12.4%, (Vitit 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 13.39%, (Vitit 2021).

3. PRODHIMI I PIJEVE

Prodhimi i pijeve në Kosovë si sektorë ka historinë e sajë në prodhimin e pijeve bio nga ato jo-alkoolike dhe alkoolike. Nën sektori i pijeve nuk është lokomotivë e Sektorit C, por është industri “infante” e cila duhet mbështetur për ta thelluar tutje trendin pozitiv të rritjes së outputit dhe të punësimit, duke përfshirë edhe rritjen e konkurrueshmërisë eksportuese, si dhe thellimin tutje të efijencies së konsumit të energjisë në nivel të nën sektorit.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të pijeve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Pijeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 5.24 %, ndërsa në numër të ndërmarrjeve me 1.66 %, dhe në qarkullim vjetor me 7%, (Vitet 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Pijeve, merr pjesë me 4.9%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 5.9% (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Pijeve, merr pjesë me 2.5%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.7.%, (Viti 2021).

4. PRODHIMI I TEKSTILIT

Nën sektori i “Prodhimit të tekstilit” ka potencial për rritje të punësimit, të qarkullimit dhe rritjes së eksporteve. Nën sektori shoqërohet me rritje të konsumit të energjisë me normë më të madhe se sa rritja e VSHP-së, që flet për nevojën e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Ky nën sektor ka potencial të konsiderueshëm që të rrisë punësimin sidomos i grupeve të cenuara si vajzat dhe gratë. Qëllimi kryesor i politikave do të duhej të ishte i fokusuar tek rritja e nën sektorit si burim i punësimit, pra duke kontribuar në objektiven e tretë të zgjerimit të punësimit



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Tekstilit, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të tekstilit” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.18 %, në numër të ndërmarrjeve me 2.90% dhe në qarkullim vjetor me 1.27% (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i tekstilit, merr pjesë me 3.0%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.61%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i tekstilit, merr pjesë me 2.14%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.31%, (Viti 2021).

5. PRODHIMI I VESHJEVE

Industria e veshjeve për nga potenciali, ashtu edhe nga tërësia e produkteve, është një degë e rëndësishme në familjen e gjerë të degëve të industrisë. Nën sektori ka CAGR negative të punësimit, përkundër VSHP-së, së lart, por duhet pasur kujdes të monitorohen të dhënat e reja për vitet 2021 dhe 2022, sepse rritja e punësimit në vitin 2020 prej (1.510) ishte gati dyfishuar krahasuar me vitin 2019 (768). Kapaciteti i nën sektorit duhet parë në kuadër të objektivës së punësimit, sidomos për grupet e cenuar si gratë.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Veshjeve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të veshjeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 3.73 %, në numër të ndërmarrjeve me 6.44%, dhe në qarkullim vjetor me 0.83%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i veshjeve, merr pjesë me 1.4%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.64%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i veshjeve, merr pjesë me 3.04%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.28%, (Viti 2021).

6. PRODHIMI I LËKURËS DHE PRODUKTEVE PREJ LËKURËS

Industria e lëkurës në Kosovë e ka zanafillën në traditën e regjësve të lëkurës dhe saraçëve për përpunimin e lëkurës dhe prodhimin e këpucëve dhe daton që nga viti 1945. Prodhimet e lëkurë-këpucëve kanë filluar rënie sistematike të prodhimit industrial që nga viti 1989/1990, si pasojë e regjimit i cili zgjati deri në periudhën e luftës në vitet 1998/1999.

Përkundër rënies së CAGR për periudhën 2015–2020, ekziston impakt pozitiv në gjenerim të punësimit. Megjithatë, duhet pasur kujdes sepse CAGR e lartë e punësimit paraqitet si e tillë marrë parasysh bazën e ulët të punësimit në vitin 2015 prej (247), ndërsaq punësimi është ulur nga 855 në vitin 2019 në 633 në vitin 2020. Kjo e fundit mund të jetë ndikuar nga pandemia me Covid-19. Nën sektori duhet të merret parasysh në kombinim me nën sektorët e veshjes dhe tekstilit për rritje potenciale të sinergjisë mes tyre në zhvillimin edhe të produkteve të reja, si dhe në gjenerimin e punësimit për grupet e cenuara.




Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 1.1%, në numër të ndërmarrjeve me 0.6% dhe në qarkullim vjetor me 0.5%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, merr pjesë me 0.44%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 0.53%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, merr pjesë me 1.07%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.15%, (Viti 2021).

7. PRODHIMI I DRURIT DHE I PRODUKTEVE TË DRURIT DHE TË TAPËS, PËRVEÇ MOBILIEVE; PRODHIMI I ARTIKUJVE NGA KASHTA DHE MATERIALEVE TË GËRSHETUARA- THURJE

Nën sektori i përpunimit të drurit në Kosovë, konsiderohet me potencial në të gjitha analizat e konkurrueshmërisë. Nga shtetet anëtare të BE-së, Suedia prodhoi 73 milion m³, në 2017, e ndjekur nga Finlanda, Gjermania dhe Franca (secila prodhon midis 51 dhe 64 milion m³). Pothuajse një çerek (23.2%) e prodhimit të drurit, 28 vendet e BE në vitin 2017 u përdorën si lëndë djegëse, ndërsa pjesa tjetër ishte përdorur për industrinë e drurit dhe rimeso, ose për prodhimin e pulpës dhe letrës.



Nën sektori i prodhimit të drurit, tregon për mungesë të konkurrueshmërisë në eksport, me bilanc tregtar negativ (5.8 milionë euro). Mbështetja e nën sektorit duhet parë në kuadër të prodhimit të inputeve apo produkteve të ndërmjetme për nën sektorët e tjerë, si mobilieria, ndërtimtaria, metali, etj.

Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara- Thurje, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Drurit” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 5.48%, në numër të ndërmarrjeve me 8.21% dhe në qarkullim vjetor me 3.82%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Drurit, merr pjesë me 1.86%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.24%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Drurit, merr pjesë me 2.09%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.26%, (Viti 2021).

8. PRODHIMI I LETRËS DHE PRODUKTEVE PREJ LETRËS

Nën sektori i letrës është ndër industritë kryesore në botë, konsumi i letrës dhe prodhimi i saj është në rritje të vazhdueshme.

Në Kosovë, kryesisht prodhohen: thasë nga letra, qese të letrës, karton i valëzuar për ambalazhim, kutitë sipas kërkesave të tregut, letër kuzhine, tualeti, faculeta, etj.

Ky është nën sektor me potencial (niche), por nuk shihet si nën sektor që mund të bëhet shtytës serioz në ndonjërin nga objektivat e politikës industriale. Nën sektori ka bilanc tregtar negativ (8.5 milionë euro). Kjo mund të jep indikacione për mungese të konkurrueshmërisë, dhe natyrës së politikave tregtare.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Letrës dhe Produkteve prej Letrës, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Letrës dhe Produkteve prej Letrës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 1.6%, në numër të ndërmarrjeve me 1.8% dhe në qarkullim vjetor me 1.9%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës, merr pjesë me 0.53%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 0.64%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës, merr pjesë me 1.63%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.76%, (Viti 2021).

9. PRODHIMI I PRODUKTEVE KIMIKE

Industria kimike është një nga degët e rëndësishme të ekonomisë moderne dhe produktet saj përdoren në sektorë tjerë të ekonomisë, siç është bujqësia, prodhimi, ndërtimi dhe shërbimet.

Nën sektori ka bilanc të thellë negativ tregtar. Ky bilanc vë në pah mungesën e konkurrueshmërisë së nën sektorit në raport me importet. Megjithatë nën sektori si i tillë nuk konsiderohet të jetë intensiv për nga punësimi.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Produkteve Kimike, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve Kimike” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2%, në numër të ndërmarrjeve me 2% dhe në qarkullim vjetor me 2%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Kimike, merr pjesë me 2.89%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.49%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Kimike, merr pjesë me 7.85%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 8.47%, (Viti 2021).

10. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË GOMËS DHE PLASTIKËS

Produktet kryesore që prodhohen nga ndërmarrjet e gomës dhe plastikës në Kosovë janë: prodhimi i qeseve, thasëve për mbeturina, bocave fryrëse, shisheve plastike, kutive plastike farmaceutike dhe për argjendari, dritareve dhe dyerve të plastikës, roletave, gypave të plastikës për ujë dhe kanalizim, kova plastike, ambalazh plastike për jogurt, pastaj mbështjellëse të gomave, plastika të gomës, rripa trapez, shirita transportues, lodra te ndryshme prej gomës dhe plastikës, etj.



Ky nën sektor karakterizohet me angazhim të konsiderueshëm të fuqisë punëtore. Kësisoj, është nën sektor i rëndësishëm për avancimin e objektivës së tretë të politikës industriale që lidhet me gjenerimin e punësimit. Shihet si nën sektor përgjithësisht i shëndetshëm me potencial të rritjes dhe kontribut po ashtu edhe në zgjerimin e bilancit pozitiv tregtar. Implikimet e politikave janë që ky nën sektor mund të mbështetet në kuadër të objektivës së katërt që lidhet me krijimin e një ekonomike qarkore, duke përfshirë edhe automatizimin e teknologjisë dhe digjitalizimin. Po ashtu, tregu evropian ka kërkesë për produkte më të sofistikuara që lidhen me këtë sektor, gjë që mund të shërbejë për rritje tutje të kapacitetit furnizues të këtij nën sektori.

Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Produkteve të Gomës dhe Plastikës, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve të Gomës dhe Plastikës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 10%, në numër të ndërmarrjeve me 10% dhe në qarkullim vjetor 11.5%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe Plastikës, merr pjesë me 10.39%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 12.54%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe Plastikës, merr pjesë me 4.38%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 4.73%, (Viti 2021).

11. PRODHIMI I PRODUKTEVE MINERALE JO – METALIKE

Sipas të dhënave statistikore, në Kosovë kryesisht prodhohen: produkte prej betonit për qëllime ndërtimi, beton i përzier i gatshëm për ndërtim, thyerje e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare, prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur, prodhimi i llaqeve, formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët etj. Nën sektori ka bilanc të konsiderueshëm tregtar negativ (16 milionë euro). Megjithatë, është nën sektor me ndikim të konsiderueshëm në kuadër të Sektorit C, sidomos në punësim.




Nën sektori i Prodhimit të produkteve minerale jo-metalike

- Nën sektori i “Prodhimit të produkteve minerale jo-metalike” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 12.48%, në numër të ndërmarrjeve me 8.8% dhe në qarkullim vjetor me 8.8%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike, merr pjesë me 2.48 %, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.0%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike, merr pjesë me 4.81%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 5.19%, (Viti 2021).

12. PRODHIMI I METALEVE

Prodhimi i metaleve, përfshin ndarjen e veprimtarive të shkrirjes dhe/ose rafinimit të metaleve me ngjyrë dhe pangjyrë nga xehërorja, metali i shkrirë ose nga mbeturinat, duke përdorur procese dhe teknika elektro-metalurgjike dhe procese të tjera metalurgjike. Po ashtu përfshin prodhimin e përzierjeve të metaleve dhe super-përzierjeve duke futur elemente të tjera kimike në metalet e pastra.



Nën sektori ka bilanc tregtar negativ të lartë 75 milionë euro). Ky nën sektor ka sfida të marrë parasysh faktin se VSHP-ja është në rënie dhe bilanci i theksuar tregtar tregojnë për probleme serioze në konkurrueshmëri. Megjithatë, arsyeja e konsumit në ulje të energjisë lidhet me faktin që është një ndërmarrje e madhe në këtë nën sektor. Me rastin potencial të rritjes me kompani të tjera, do të mund të kishte konsum më të lartë të energjisë, gjë që e vë në dyshim argumentin e rritjes së eficientes së energjisë. Është nën sektor me VSHP në rënie, që mund të jetë indikator se duhet pasur kujdes në politikat mbështetëse dhe nëse ka potencial të gjenerojë vende pune. Po ashtu, ka probleme politike të aktivizimit të minierave të caktuara, si dhe të shkritoreve. Ndikimi mjedisor i këtij nën sektori është me potencial negativ prandaj duhet pasur kujdes për masa lehtësuese.

Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Metaleve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Metaleve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 3.38%, në numër të ndërmarrjeve me 2% dhe në qarkullim vjetor 4.5%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Metaleve, merr pjesë me 17.43%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 21.03%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Metaleve, merr pjesë me 8.09%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 8.73%, (Viti 2021).

13. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË FABRIKUARA METALIKE, PËRVEÇ MAKINERISË DHE PAJISJEVE

Ky nën sektor përfshinë, përpunimin e produkteve nga metali duke i shndërruar në produkte finale si: thika, doreza, cilindra, veglave të ndryshme, kaçavida, tel dhe disa produkte të tjera. Përpunuesit e metalit në Kosovë, mund ta shtojnë në masë të madhe vlerën e metaleve që destinohen për eksport dhe njëherësh t'i përmbushin kërkesat e tregut vendor me cilësi më të mirë dhe çmime më të ulëta.

Rritja pozitive e VSHP-së dhe punësimit koïncidon me bilanc tregtar negativ (20.8 milionë euro). Nën sektori kontribuon në rritjen e sektorit të ndërtimit. Duhet parë se si të mbështeten ndërlidhjet e nën sektorit 24 me atë 25 si dhe me sektorin e ndërtimit.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 8.5%, në numër të ndërmarrjeve me 13% dhe në qarkullim vjetor me 8.8%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, merr pjesë me 6.98%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 8.42%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, merr pjesë me 3.22%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.48%, (Viti 2021).

14. PRODHIMI I MOBILEVE

Industria e mobileve është industri e mbizotëruar nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera të BE-së. Ndërmarrjet të cilat merren me prodhimin e mobileve janë duke instaluar procesin teknologjik të modernizuar edhe pse kanë vështirësi, në mungesë të financave. Megjithatë produktet në nën sektorin “Prodhimi i mobileve” kanë cilësi të mirë dhe po ashtu kanë trend të rritjes në eksporte. Nën sektori i prodhimit të mobileve në Kosovë, ka vend të rëndësishëm me pjesëmarrjen e numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksporteve dhe qarkullimit në industrinë prodhuese.



Përkundër, VSHP-së pozitive dhe bilancit pozitiv tregtar, ka korrelacion negativ në mes të VSHP-së dhe punësimit (me rënie të CAGR të punësimit prej 0.4 %). Ky është nën sektor i rëndësishëm dhe shtytës për ekonominë e vendit dhe për Sektorin C në përgjithësi. Ndonëse rritja e punësimit është çështje për t'u monitoruar, nën sektori duhet mbështetur tutje për thellim të konkurrenshmërisë eksportuese dhe rritje të punësimit.

Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Mobileve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Mobileve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 15%, në numër të ndërmarrjeve me 10% dhe në qarkullim vjetor me 11%, (Viti 2022);
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Mobileve, merr pjesë me 18.52%, (Viti 2021);
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 22.35%, (Viti 2021);
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Mobileve, merr pjesë me 1.31%, (Viti 2021);
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.42%, (Viti 2021).

Broshura është përgatitur nga Departamenti i Industrisë/**Divizioni për Politika Industriale**.

Kontakti:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Departamenti i Industrisë, Divizioni për Politika Industriale

Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +383 38 200 36 547

<http://www.mint-rks.org>

